



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



01/Nr.2932/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligji Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 neni 9, pika 6, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2025 merr këtë:

V E N D I M

Për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025

1. Kuvendi i Komunës miratoi kërkesën me numër 04/Nr/2932/2025 për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025.
2. Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2023 në vitin 2024 janë në shumë prej 133,030.00 €, prej të cilave janë shpenzuar vetëm 124,143.00 € dhe për bartje kanë mbetur vetëm 8,887.00 €. Ndërsa, të hyrat e realizuara gjatë vitit 2024 janë në shumë prej 317,021.00 € prej të cilave janë shpenzuar vetëm 155,136.00 € ndërsa për bartje janë në shumë prej 161,885.00 €. Pra, shuma e pashpenzuar nga fondi 21 dhe 22 i vitit 2024 është në shumë prej 170,771.67 €, të cilat i bartim në vitin 2025 në këto Nën-Programe dhe kategori buxhetore, si vijon:
 - Mallra dhe shërbime në shumë prej 15,860.96 €,
 - Subvencione dhe Transfere në shumë prej 5,000.00 € dhe
 - Shpenzime Kapitale në shumë prej 149,910.71 €.
3. Në kategorinë buxhetore Mallra dhe Shërbime :
 - Buxhetimi (17535), kodi funksional (0112), shuma prej 2,000.00 €,
 - Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarrit (18444), kodi funksional (0320), shuma prej 5,860.96 €,
 - Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej 5,000.00 €,
 - Arsimi Parafillor – Çerdhja (92890), kodi funksional (0911), shuma prej 3,000.00 €.
4. Në kategorinë buxhetore Subvencione dhe Transfere:
 - Arsim dhe Shkencë:
 - Administrata (92175), kodi funksional (0980), shuma prej 5,000.00 €.

5. Në kategorinë buxhetore Shpenzime Kapitale:

- **Planifikimi Urban dhe Inspekcioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej 88,771.67 € në këto projekte kapitale:**

“Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në rr,Adem Jashari, Udha e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë” me kod (53370) në shumë prej **5,500.00 €**,

“Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik me kod (53471), në shumë prej **41,693.00 €**,

“Asfaltimi i rrugës Eksodi 99 – Hani i Elezit”, me kod (55037), në shumë prej **8,000.00 €**,

“Asfaltimi i rrugës “Nehat Curri” lagja Curri - Dromjak”, me kod (55048), në shumë prej **33,578.67 €**,

- **Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej 1,139.04 €, në projektin:**

“Rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së në Han të Elezit dhe AMF-së në Gorancë”, me kod (45647), në shumë prej **1,139.04 €**.

- **Arsim dhe Shkencë:**

Administrata (92175), kodi funksional (0980), në shumë prej 60,000.00 € në projektin:

“Investime në pajisje të IT-së në shkollat SHML Dardania, SHFMU Ilaz Thaçi, SHFMU Veli Ballazhi dhe SHFMU Kështjella e Diturisë”, me kod (56091), në shumë prej **60,000.00 €**.

Arsyetim për bartjen e bilancit të pashpenzuar:

Bartja e mjeteve në kuadër të kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime:

- Buxhetimi (17535), kodi funksional (0112), shuma prej 2,000.00 €.

Arsyetim: Nën-Programi Buxhetor Buxhetimi (17535) me kod funksional (0112), është në mungesë financiare për të përmyllur obligimet të cilat do të vijojnë gjatë muajit vijues. Gjegjësisht, bazuar në Marrëveshjen e Komunës me Postën e Kosovës, për shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë i cili shërbim është në përfundim e sipër. Kjo bartje propozohet me qëllim të evitimit të vonesave në ekzekutimin e obligimeve financiare dhe për të garantuar përmbushjen me kohë të Marrëveshjes përkatëse.

- Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarrit (18444), kodi funksional (0320), shuma prej 5,860.96 €.

Arsyetim: Nën-Programi Buxhetor Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarrit (18444), kodi funksional (0320), është përballur me një situatë të papritur financiare, pasi që një pjesë e konsiderueshme e mjeteve financiare janë tërhequr nga Përmbaruesit për shkak të vendimeve Gjyqësore të formës së prerë. Si pasojë, ky Nën-Program Buxhetor ka mbetur pa mjete të mjaftueshme për të përmbushur obligimet e kontraktuara si dhe punët të planifikuara të realizohen gjatë muajve në vijim.

- Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej 5,000.00 €.

Arsyetim: Nën-Programi Buxhetor Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721), ka obligime të akumuluar edhe prej vitit të kaluar siç është Marrëveshja me Islamic Relief Kosova, për mbështetje me staf në QKMF si dhe pagesa për furnizime mjekësore, shërbime kontraktuale, mirëmbajtje të infrastrukturës shëndetësore, për të cilat nevojiten mjete shtesë për të mos rrezikuar ofrimin e shërbime cilësore të qytetarëve.

- Arsimi Parafillor – Çerdhja (92890), kodi funksional (0911), shuma prej 3,000.00 €.

Arsyetim: Nën-Programi Buxhetor Arsimi Parafillor – Çerdhja (92890), kodi funksional (0911). Në kuadër të këtij Nën-Programi buxhetor ekzistojnë mjete të mbetura nga viti i kaluar, rrjedhimisht, për shkak të Rregulloreve Financiare, këto mjete nuk mund të transferohen nëpër Nën-Programe tjera buxhetore por edhe janë të nevojshme për të përmbushur të gjithë obligimet pasi që gjatë vitit 2024 kemi pasur disa obligime të cilat s'kanë mundur të ekzekutohen dhe janë bartur gjatë vitit aktual.

Bartja e mjeteve në kuadër të kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere:

- Administrata (92175), kodi funksional (0980), shuma prej 5,000.00 €.

Arsyetim: Nën-Programi Buxhetor Administrata (92175), kodi funksional (0980), ka mungesë të mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00 €, pasi që këto mjete financiare janë tërhequr nga Përmbaruesit për shkak të vendimeve Gjyqësore të formës së prerë. Kjo situatë ka vënë në rrezik realizimin e plotë të procesit të ndarjes së bursave të studentëve, i cili proces përgjatë marrjes së mjeteve ka qenë në përfundim e sipër.

Bartja e mjeteve në kuadër të kategorisë buxhetore Shpenzime Kapitale:

- **Planifikimi Urban dhe Inspekcioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej 88,771.67 € në këto projekte kapitale:**

“Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në rr. Adem Jashari, Udhë e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë” me kod (53370) në shumë prej **5,500.00 €**.

Arsyetim: Propozimi për bartjen e shumës 5,500.00 € në kuadër të këtij projekti është pasi që, paramasa e projektit ka dalur më e kushtueshme nga mjetet faktike të planifikuara për këtë projekt. (Gjeni të bashkangjitur paramasën e këtij projekti).

“Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustënik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik me kod (53471), në shumë prej **41,693.00 €**.

Arsyetim: Propozimi për bartjen e shumës prej 41,693.00 € në kuadër të këtij projekti është duke qenë se ky projekt është një ndër prioritet e OB-së, i cili synon përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe lehtësimin e qasjes për qytetarët në zonën urbane dhe ato periferike. Deri më tani, kemi pranuar një numër të madh të kërkesave nga qytetarët për investime në rrugica dhe trotuare, por buxheti faktit aktual nuk është i mjaftueshëm për t’i përmbushur të gjithë kërkesat e adresuara.

“Asfaltimi i rrugës Eksodi 99 – Hani i Elezit”, me kod (55037), në shumë prej **8,000.00 €**,

Arsyetim: Ky projekt tashmë është në fazën përfundimtare të realizimit, por për shkak të zhvillimeve në teren dhe çmimeve të tregut, është mungesa e 8,000.00 € për të përmbyllur punimet në tërësi. Përmbyllja e këtij procesi është e një rëndësie të madhe si për arsye infrastrukturore por edhe për vlerat historike e simbolike që paraqet ky destinacion për komunitetin. (Gjeni të bashkangjitur Marrëveshjen e Bashkfinancimit në mes të OB-së dhe MZHR-së).

“Asfaltimi i rrugës “Nehat Curri” lagja Curri - Dromjak”, me kod (55048), në shumë prej **33,578.67 €**,

Arsyvetim: Ky projekt është në implementim e sipër, ku faza fillestare është realizuar dhe do të vijojnë punimet e fazës së dytë por edhe në këtë projekt një pjesë të mjeteve janë tërhequr nga përmbaruesit nga Vendimet Gjyqësore që rrjedhin nga Kontrata Kolektive.
(Gjeni të bashkangjitur dokumentacionet përkatëse).

- **Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050)**, kodi funksional (0721), shuma prej **1,139.04 €**, në projektin:

“Rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së në Han të Elezit dhe AMF-së në Gorancë”, me kod (45647), në shumë prej **1,139.04 €**.

Arsyvetim: Këto mjete kanë mbetur të pashpenzuara nga viti 2024 e të cilat propozohen të barten në vitin 2025, duke qenë se Rregulloret në fuqi nuk lejojnë transferin e të njëjtave në Nën-Programë tjera buxhetore.

- **Arsim dhe Shkencë:**

Administrata (92175), kodi funksional (0980), në shumë prej 60,000.00 € në projektin:

“Investime në pajisje të IT-së në shkollat SHML Dardania, SHFMU Ilaz Thaçi, SHFMU Veli Ballazhi dhe SHFMU Kështjella e Diturisë”, me kod (56091), në shumë prej **60,000.00 €**.

Arsyvetim: Te ky projekt janë përfunduar me sukses të gjithë fazat e prokurimit, është shpallur fituesi (operatori ekonomik), është nënshkruar kontrata por që në fund të muajit prill mjetet janë tërhequr nga përmbaruesit nga Vendimet Gjyqësore që rrjedhin nga Kontrata Kolektive.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- MFPT – Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.04.2025





01/Nr.2360 /2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 17 shkronja (r), 40, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 2.3, Statutin e Komunës neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 merr:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR DITËT E KULTURËS DHE FESTIVALIN MBARËKOMBËTAR HANI I ELEZIT 2025-EDICIONI I TRETË

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë Hani i Elezit 2025-Edicioni i Tretë” në Komunën e Hanit të Elezit.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi i cila i dedikohet “Ditët e Kulturës dhe Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar Hani i Elezit 2025 -Edicioni i Tretë”, mjetet financiare do të merren nga këto Nën-programe buxhetore dhe nga këto kategori, si vijon: Zyra e Kryetarit (16035), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 11,000.00 €, Shërbimet Kulturore (85035), kategoria mallra dhe shërbime (130), shuma prej 8000.00 €, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (19675), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 500.00 €, Administrata (16335), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 5000.00 €, Turizmi (48075), kategoria mallra dhe shërbime (130) shuma prej 500.00 €. Vlera e përgjithshme e mjeteve financiare për mbështetje “Ditët e Kulturës dhe Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar Hani i Elezit 2025-Edicioni i Tretë” është në shumë prej 25,000.00 €.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen;

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.04.2025





01/Nr.2930 /2025

Në bazë Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), Ligjit nr.03/L233 për Mbrojtjen e Natyrës neni 19 dhe 20, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 11, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.04/2023 për Administratë të Hapur, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 merr :

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË STUDIMEVE DHE EVIDENTIMIT TË VLERAVE TË TRASHIGIMISË NATYRORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT TË PROPOZUAR PËR MBROJTJE LIGJORE NGA INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

1. Kuvendi i Komunës shqyrtoi dhe miratoi në parim raportin e studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashigimisë natyrore në territorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
2. Vlerat e trashigimisë natyrore të propozuara për mbrojtje ligjore në territorin e Komunës Hani Elezit bazuar në raportin e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, janë:

Tabela e trashigimisë natyrore në komunën e Hanit të Elezit

Nr.	Vendi	Objekti	Komuna
1.	Hani i Elezit	Parku dhe Ujëvara	Hani i Elezit
2.	Dromjak	Kanioni	Hani i Elezit
3.	Dromjak	Trungu i Bungëbutes (Quercus pubescens)	Hani i Elezit
4.	Gorancë	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens)	Hani i Elezit
5.	Pustenik	Kepi i gjatë dhe burimi i ujit	Hani i Elezit

3. Obligohet Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit, që në pajtim me nenin 20 të Ligjit nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës si dhe U/A nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna të organizoj diskutimin publik të Raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashigimisë natyrore në territorin e Komunës Hani i Elezit të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

4. Shqyrtimi publik i raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashigimisë natyrore në territorin e Komunës Hani i Elezit zgjatë 30 (tridhjetë) ditë. Ndërkaq hapja zyrtare dhe shpallja e shqyrtimit publik bëhet së paku 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit dhe ueb faqes zyrtare të komunës.
5. Ky vendim hunë në fuqi 30 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.04.2025

